


**REPUBLIKA E KOSOVËS**

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA

**KOMUNA E DEÇANIT**

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

Drejtoria e Arsimit**Nr.07-Zyrtarisht****09.07.2020**

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës, nr. 03/L-212, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.90/2010), Neni 5 pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit Publik Neni 4. Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 10/2018 datë: 20.07.2018. Për Normativin Mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2015 Normativi Për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, dhe kërkesave nga Departamenti për Politika të Arsimit Parauniversitar në MASHT Drejtoria për Arsim shpallë:

KONKURS*Për plotësimin e vendeve të punës*

Nr.	Niveli, Shkolla	Pozita	Vend i Lirë /Zëvendësim	Numri i pozitive
1	SHML "Vëllezërit Frashëri" Deçan	Mësimdhënës i/e Gjuhës Gjermane (Rishpallje)	Vend i Lirë	1
2	SHFMU "Ardhmëria" Beleg	Mësuese Klase	Zëvendësim Lehonie	1
3	SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan	Mësuese Klase	Zëvendësim Lehonie	1
4	SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan	Gjuhë Angleze	Zëvendësim Lehonie	1
5	SHFMU "Drita" Gramaçel	Gjuhë Angleze	Zëvendësim Lehonie	1
6	SHFMU "Drita" Gramaçel	Mësuese Klase	Vend i Lirë	1
7	SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan	Punëtor Teknik	Vend i Lirë	1
8	SHFMU "Dëshmorët e Kombit" Strelle i Ulët	Punëtor Teknik	Vend i Lirë	1
9	SHFMU "Bajram Curri" Strelle i Epërm	Punëtor Teknik	Vend i Lirë	1
10	SHMP "Tafil Kasumaj" Deçan	Mësimdhënës i/e lëndëve të mjekësisë	Vend i Lirë (13 orë)	1
11	Drejtoria e Arsimit – Deçan	Asistent për fëmijë/nxënës me nevojë të veçanta arsimore	Vend i Lirë	2

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente: Formulari i aplikimit; Rezyrmeja personale (CV); Dokumenti personal (letërnjoftimi ose pasaporta); Diplomë e kualifikimit (ose certifikatat); certifikatat në vend të diplomës jo më të vjetra se gjashtë muaj, Trajnime (nëse ka), Dëshmitë e përvojës së punës (nëse ka), Certifikata që nuk jeni nën hetime, Certifikata e lindjes, Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomë e nostrifikuara në MASHT.

Kriteret e kualifikimit për punëtor teknik: shkollimi bazik.

Kriteret e kualifikimit: Për vendin e punës Asistent për fëmijë/nxënës me nevojë të veçanta kërkojnë kualifikimet: Shkolla e mesme dhe Niveli 5-të (post sekondar) i kualifikimit asistent për fëmijë/nxënës me nevojë të veçanta arsimore.

Formulari i Aplikimit për Punësime, Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë dhe orari i intervistave publikohet në gazetën Bota Sot dhe web-faqen e Komunës së Deçanit: <https://kk.rks-gov.net/decan/>

Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje, (kualifikimet universitare duhet të jenë të noterizuara të noteri), dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkojnë me rastin e intervistës.

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit më: **09.07.2020 më datën: 24.07.2020**

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet përmes protokollit, përkatësisht përmes zyrës së DKA-së – Zyra Nr. 52 (Kati-III-të), në objektin e Komunës së Deçanit.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshërisht më datë 01.09.2020, por në vartësi të lirimit real të punës.

Personat gjatë aplikimit duhet të ruajnë distancën fizike, dhe të kenë masat mbrojtëse kundër Covid-19.

